



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 109

Prishtinë, më 31.10.2024, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Yllëza Hoti, Halil Thaçi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku dhe Albana Bytyçi.

Munguan: Visar Korencia, Rashit Qalaj, Hajdar Beqa, Bekim Arifi dhe Adem Hoxha.
Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit tjerë: Fjollë Haziri, KDI; Driada Thaçi, ZKA; Bekim Gashi, Shkurte Sadiku dhe Artizana Krasniqi, GP-LVV; Gent Ramosaj, GP-AAK.

Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 8.10.2024;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Komisionin e Pavarur për Media për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023;
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 8.10.2024

Procesverbali nga mbledhja e mbajtura më 8.10.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Komisionin e Pavarur për Media për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ky raport ka opinion të pamodifikuar. Raporti ka rezultuar me një gjetje, që ka të bëjë me funksionimin e pozitive të larta udhëheqëse me ushtrues detyre. Pozita e kryeshefit ekzekutiv të KPM-së, funksionon me u.d./zëvendësues për një periudhë të gjatë, saktësisht nga 1 korriku i vitit 2021. Kjo nuk është e lejuar me Ligjin për zyrtarët publikë.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të KPM-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për KPM-në. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Raporti i auditimit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2023, ka opinion të pamodifikuar. Ky raport ka 2 gjetje. Njëra ka të bëjë me mosrespektimin e procedurave për servisim të automjeteve. Në pagesën për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve, në vlerë 6,113€, në 17 servisimet/riparimet e realizuara në këtë pagesë për 10 vetura, mungonin formularët me të dhënat e automjeteve, duke përfshirë arsyen e servisimit dhe defektet e paraqitura në automjete.

Gjetja tjetër ka të bëjë me moskryerjen e inventarizimit të pasurisë brenda afatit ligjor. Ky proces duhet të përfundojë para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të KQZ-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për KQZ-në. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ky raport, po ashtu ka opinion të pamodifikuar. Por pavarësisht opinionit, ky raport ka rezultuar me 3 gjetje, por që sipas ZKA-së, janë jomateriale. Gjetja e parë ka të bëjë me zotimin e mjeteve dhe nxjerrjen e urdhërblërjes, pas pranimit të faturës. Në 6 pagesa me vlerë të pagesave prej 4,952€, zotimi i mjeteve dhe urdhërblërjet ishin proceduar

pasi kishte ardhur fatura. Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Gjetja e dytë, ka të bëjë me mosprotokollimin e faturave të pranuar. Në 2 raste, me vlerë të pagesave prej 3,300€, janë realizuar pagesa bazuar në fatura, të cilat nuk ishin protokolluar nga organizata.

Gjetja e tretë është mospërdorimi i sistemit e-pasuria. Pra, ZRRE, regjistrimin e pasurisë jo-kapitale dhe stoqet, i mban në regjistra të brendshme në formatin “Excel”.

Albana Bytyçi: Unë vetëm e pash që janë pajtuar me gjetjet përpos gjetjes A1. Kisha dashur të diskutoj më në detaje. Por, palët nuk i kemi të ftuar, edhe pse komentet i kishin dhënë edhe me shkrim. Por, pasi nuk janë materiale, jemi në rregull edhe me këtë raport.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të ZRRE-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për ZRRE-në. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

6. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Të nderuar kolegë, siç jeni njoftuar, më datë 31 tetor dhe 1 nëntor, e kemi një delegacion homolog nga Shqipëria, ku ne do t'i shkëmbejmë me ta përvojat tona, sesi funksionojmë si komision.

Ndërsa, sa i përket takimit me ministrin e Financave për shqyrtimin e RVA-së, kemi kërkuar disa herë nga ministri, po ashtu i kemi lënë alternativë ta caktojë vetë datën e përshtatshme. Ata kanë thënë, në një nga komunikimet, që mund të vijë drejtori i Thesarit, për të cilin të gjithë e dimë që është caktuar vetëm që 1 muaj. Sipas ligjit, afati ligjor për shqyrtimin e RVA-së, vetëm se kalon sot. Ky raport asnjëherë nuk është shqyrtuar pa prezencën e ministrit të Financave. Por, ne do të presim nëse do të kemi konfirmim për ndonjë nga ditët në vazhdim, nëse jo, atëherë në takimin e radhës e propozojmë për seancë.

Nëse nuk keni diçka për të shtuar, me kaq e mbylli takimin për sot.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit